



THIRRJE PËR FILMA

Të gjithë Romëve, Sinti, Kale, Kalderash, Lovara, Lalleri, Ursari, Beasch, Manouches, Ashkali, Aurari, Romanichals, Droma, Doma, Gypsies, Travellers dhe gjithë grupeve tjera rome në botë ...

Edicioni i katërt i Festivalit të Filmit Rom do të mbahet në Berlin në vitin 2020:

AKE DIKHEA?
Festivali i Filmit Rom
19 – 23 Nëntor 2020

Ne jemi në kërkim të filmave me të cilët mund të identifikohen anëtarët e grupeve të ndryshme rome. Personat me prejardhje rome apo organizatat mund të propozojnë filma nga producentët rom dhe jo-romë temat e të cilave kanë të bëjnë me jetën e romëve në botë dhe në mënyrë kritike reflektojnë mbi realitetin e diskriminimit.

Mundësitë e regjistrimit të filmit:

FilmFreeWay: <https://filmfreeway.com/AkeDikhea>

Form: <https://bit.ly/2NiDumj>

E-mail: info@roma-filmfestival.com

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve:

E Dielë, 9 Gusht 2020

Informatat bazike:

AKE DIKHEA? Që do të thotë "A pe sheh?" Është një festival i vetëorganizuar, ndërkombëtar i filmit Rom që do të zhvillohet në Berlin në nëntor të vitit 2020. Festivali prezanton Berlinin, Gjermaninë dhe mbarë botën nga perspektiva e popullit Rom: Cilët filma na përfaqësojnë, cilat tema janë të rëndësishme për ne, si e shohim veten dhe si duam të na shohin? Ne nuk duam të presim derisa dikush të na japë zë. Ne duam ta formësojmë vetë hapësirën sociale dhe të vendosim për temat dhe strukturën e ngjarjeve të festivalit.

Festivali është i organizuar nga vetëorganizimi i Romëve të Berlinit RomaTrial në bashkëpunim me kinemanë më të vjetër të Gjermanisë, Movimiento.

Informacione të mëtejshme mund të gjenden në uebfaqën roma-filmfestival.com.

Procesi i përzgjedhjes

Festivali i Filmit Rom **AKE DIKHEA?** E ka një proces unik dhe pjesëmarrës të përzgjedhjes: Falë rrjetit tonë të gjërë në mbarë botën me producentët (Rom) të filmave, kemi mundësi që të zbulojmë tema, njerëz dhe perspektiva që përndryshe do të mbeteshin të fshehura apo do të kishin vetëm ndikim local apo kombëtar. I gjithë procesi është shumë gjithëpërfshirës:

Midis 1 korrikut dhe 9 gushtit 2020 do të mbledhim propozime dhe aplikime për filma nga komunitete të ndryshme romë, palë të interesuara dhe individë.

Në fund të gushtit 2020, një juri ndërkombëtare - profesionistë të filmave romë dhe jo-romë - do të takohet në Berlin për të diskutuar një maksimum prej 50 filmash të paracaktuar nga drejtori artistik Hamze Bytyçi. Së bashku ata do të zgjedhin rreth 10-20 filma të shkurtër dhe me metrazh të gjatë që do të prezantohen në festivalin e filmit.

I pranojmë të gjitha zhanret dhe metarzhet e filmit. Pranojmë vetëm filma nga producentë romë dhe jo-romë që në shkallën më të lartë reflektojnë paragjykimeve ndaj popullit Rom.

Udhëzime për propozim

- **Vetëm individë dhe organizata që e identifikojnë veten si organizata ose individë romë (ose Sinti, Kale, Kaledarash, Lovara, Laleri, Ashkali, Aurari, Gypsies, Travellers...) mund të propozojnë ose të paraqesin filma.**
- Pranojmë vetëm filma nga producentë romë dhe jo-romë që me shkallën më të lartë reflektojnë paragjykimet ndaj popullit rom.
- Formulari i regjistrimit duhet të plotësohet për secilin film – gëzohemi nëse mund të ju ofrojmë mbështetjen tonë.
- Dorëzimi i filmave është pa pagesë.
- Mund të regjistroni filma të shkurtër, si dhe filma me metrazh të gjatë, ne i pranojmë të gjitha zhanret e filmit.
- Pranojmë filma pavarësisht nga viti i prodhimit.
- Çdo individ ose organizatë mund të propozojë maksimum pesë filma me metrazh të gjatë dhe dhjetë filma të shkurtër.
- Nëse filmi nuk është në anglisht, duhet të jetë i titruar në anglisht.
- Nuk pranojmë filma të papërfunduar. Nga ju kërkohet të propozoni dhe regjistroni vetëm filmat e përfunduar që janë gati për shfaqje publike. Nuk do të jetë e mundur të paraqisni një version të ri të filmit pas afatit të aplikimit.